

BIBLIOTEKA

E  
8SH-1

G 92

11131HS

GJIROKASTER



PANO ÇUKA

ÇELËSAT

LUMTURISË

85H-1  
5 92

PANO ÇUKA

# ÇELËSAT E LUMTURISË

Shqipëri: DRITERO AGOLLI



SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## SHËNIM PËR LEXONJËSIT

Pano Çuka është një poet nga minoriteti i vogël grek. Ai lindi në fshatin Sopik të krahinës së Pagonit më 1925. Ky poet, që përherë të parë del para lexuesëve në gjuhën shqipe me vëllimin «Çelësat e lumenjës» ka botuar në greqisht disa vëllime poetike si «Jetë e lirë», «Traktoristja», «Vjersha», «Drita e Totorit», «Agime e perëndime». Vargjet e Pano Çukës përshkohen nga fryma e shëndetëshme e kohës dhe nga pathosi romantik i ditëve tona.

Përveç vjershave, Pano Çuka ka botuar në organet e shtypit, sidomos në gazeten «Llajko Vima», ku ai punon si redaktor, shumë tregime, përshkrime, reportazhe letrare, fejtone, reçensione etj.

Një kontribut të rëndësishëm ai ka dhënë edhe në fushën e përkthimeve. Ka përkthyer e botuar në greqisht «Lulet e verës» të Naim Frashërit, një përbledhje me vjersha të Andon Zako-Çajupit «Mëmedheu», vëllimin e Migjenit «Vargjet e lira», një antologji të poesisë klasike shqipe «Lira shqiptare», një antologji tjeter me vargje të zgjedhura nga poezia e sotme shqipe «Bomba e flamuj», romanin e Sterio Spasses «Afërdita përsëri në fshat» etj.

## PARTIA FLET...

Partia flet...

Dhe Shqipëria  
dëgjon krenare  
si amazonë.

Sytë e saj si yje  
në oqean të dritave notojnë.  
Asaj i kanë lënë kallo në duar  
çekani,

pena,  
tornoja,  
drapëri.

Kurora e lavdisë i ka praruar  
flokët e saj  
të ashpëra.

Partia flet...

Dhe Shqipëria  
hedh sytë e saj në vitet që vijnë:  
Rëndoja

nga lëngu i frutit  
molla,  
hardhia;

dritaret në pallate vetëtijnë,

gulçojnë uzinat,

fabrikat

dhe tymojnë oxhaqet, çibukët e gjatë...

Miliona yje-elektrike

Varen si florinj në gjoksin e natës.

Partia flet...

Dhe kuajt e erës

shpérndajnë fjalët e saj të flakta

në eterin e gjerë

me miliona flatra...

Dhe veshët e punëtorëve bëhen antena

dhe transmetojnë në marrësit-zemra

fjalët e saj, që çajnë rrugë të reja,

rrugë të reja me të reja emra,

drejt diellit

në horizontet pa anë,

fjalët e saj që i bëjnë duart më të forta

për të mbajtur të paqës çekane,

për të hapur në yjet porta.

Po këto fjalë

duart i mësojnë

të rrokin pushkën e trimit,

gjerdhanë e fishekëve në brez të shtërngojnë,

të hedhin rrufenë e zemërimit...

## REPUBLIKËS

Erdhe si agim, që përze një natë sterre,  
erdhe si kurorë, që thurrin Fitorja dhe Liria,  
erdhe si vjen e ngarkuar me shpresa një pranverë  
dhe dimrit i the:

«M'u shporr nga Shqipëria!»

Shtigjeve ku kalove s'kishim shtruar dafina.  
po të ritë e tyre shtruan djemtë petrita.  
Erdhe, o Republikë, në male, fusha, lugina  
e shoqëruar nga puna dhe drita.

## STROFA PËR DITËN KUR ERDHËN PARTIZANËT...

1

Me flatra të zeza nata kish mbështjellë  
majën e malit, pyllin, rrugën, zabelë.  
Asgjë s'pipëtinte e s'merrete frymë  
nën fërtymë!

2.

Papritur qetësia e rëndë e sëmuri;  
qetësia e natës me yje të mekur  
u gris, u trondit nga krisma dyfeku:  
triumfi shpaloste mes natës flamuri...

3.

Përpara, vëllezër; përpara, shokë!  
«Të shëmbet kjo strofkë, të digjet kjo strofkë,  
q'emblemë ka knutin e hidhur farmak,  
që rri si gur varri mbi gjokset  
mbi gjokset fshatare mbytura në gjak...»

Rufe e breshër plumbash  
shpërthen nga tyta dyfekësh.  
Trondit dyer, dritare...  
Rënkojnë armiqtë si ujqër me plagë  
dhe zgjohen nga gjokset e tyre  
me mijra lepuj, me mijra lepuj...  
Kusarët e frikshëm, kusarët fodullë,  
që dinin hapin ta hidhnin parakalimeve,  
që dinin përmendësh thirrje dhe urdhra,  
mësuan tani përmendësh një thirrje tjetër:  
«Mama mia!»

Shigjetat e bardha të diellit lëruan qellin  
dhe ngritën lart vesën si afsh kaltërosh.  
Dukej sikur toka, që vdekjen kish flakur,  
po merrte frysë nga gjiri i saj madhështor... .

Kur buzëqeshjen e parë agimi e hodhi  
në majat e larta të maleve,  
që kishin qeleshe të bardhë mënjanë,  
të endur nga duart e padukëshme të dimrit,

u hapën portat e shtëpive dhe rendën  
të vegjël, të mëdhenj me këmbë të lehta,  
sikur të përshëndetnin vëllanë e zemrës,  
që e prisin me vite, në çastin ku lajmëtari  
sjell befas sihariqin e madh të ardhjes.  
Rendën të shohin plot mburrje Shqiponjat,  
që shkundën më forcë tërmeti  
kalanë e dhunës, e cila kish kyçur në gjirin e saj

muzikën e paarritëshme të një hymni  
për jetën, që dërmonte jetën,  
që fshihte trokun e së ardhmes...  
Vështrimet bienë embël mbi fytyrat zeshkane  
dhe çdo sy shëmbëllen me objektiv fotografi,  
që portrete partizane fikson në fletët e zemrës.

6.

Kundruall qëndron me dyer e xhamë të thyer  
shtëpia, që e quanim gjer mbrëmë «Komandë»  
dhe natën u bë varr i heshtur, i ftohtë  
për ata, që kazmë varrëmihësi mbanin.  
O, sa kujtime farmak i zgjon të mjeruarëve  
kjo strofkë e shkretuar bishash gjakatare,  
që prishnin ajrin e pastër të fshatit shtëpi-ulët  
me gérhitjen e tyre të rëndë...

7.

Dielli, i dashuri flokë argjentë i ditës,  
shkelte ngadalë në gëzofin e qiellit  
dhe vallja rrotull sillej...

Të zënë për dore  
vallzonin të çiruarit, vallzonin çirimtarët.  
Kur vallja u prish, fshatarët rrethuan  
ata yjestolisurit, që, si dallëndyshe,  
lajmëruan pranverën plot hir të lirisë,  
dhe kush e kush kërkonte mysafirë t'i merrte...  
Sofrat ishin të varfra, zemrat ishin të pasura,  
siç ishte ngaherë e pasur me dashuri  
zemra popullore.

(Dhe pasuri më e madhe është pasuria e zemrës)

## 8.

Si bletët nga hojet, dolën fshatarët nga kasolle<sup>t</sup>  
dolën të përcillnin shqiponjat,  
që si Gjergj Elez Alitë  
me bajlozin luftuan,  
dhe gurrën e shënjtë të jetës të hapin,  
që e mbante të mbyllur  
dhe s'e linte të derdhej ujin kristalor  
dhe s'e linte të njomte buzët e zhuritura  
të vegjelisë së mjërë... .

Duart plot kallo lëviznin shamitë e bardha dëborë,  
si krahë pëllumbash, që shtrihen në erë,  
zemrat gufonin dhe kërciste i zjarrtë nga buzët  
urimi:

«Udhembarë!»

Dhe bashkohej urimi me krismën e pushkëve  
dhe bashkohej urimi me zërin e këngës,  
që ngjitej lart në zenit,  
dhe një rrënqethje të shënjtë lëshonte në trupat,  
rrënqethje, që digje si vetëtimë:  
«Përpara ju, o të munduar!»

## 9.

Më të pakta ishin shqiponjat dje, më shumë po  
iknnin sonte.  
Fshati përçolli bashkë me ta edhe dymbëdhjetë.  
Krah tyre me opinga partizane marshonte  
Liria e bukur dhe e rreptë... .

## CLIRIMI

Me shekuj maleve themel graniti  
në dyluftim të jetës e të vdekjes,  
në kroje gjaku të flijimeve.  
në perëndime sysh të ëmbël e të pastër,  
çlirimi rrøba dhëndërie përgatiste  
të zgjidhte nuse Shqipërinë,  
që zemrën ja kish falur  
dhe e priste ngaherë e zhuritur.

... Me krenari u nisën varg dasmorët  
dhe vallen e luftës gjer në fund e hoqën  
dhe gjakun e tyre shndruan në rubine  
për të stolisur vellon nusërore.  
Me bujari Fitorja gostiste  
qytetet edhe fshatrat, që pastruan  
rrugët të kalonte dhëndri...

## Y J E T

Dëshmorë, dëshmorë të trimërisë,  
e pabesa vdekje mes plumbash tulitur  
ju kyçi zemrat kur ju Lirisë  
një fron të hirshëm i kishit ngritur.

Po nëse si trupa u shuat,  
u shndrruat në yje qiejve të Arbërisë  
dhe dritën tuaj anembanë dërguat,  
që ne të gjenim çelësat e lumtërisë.

## TE PAVDEKESHMIT

Maleve me majë të zbardhëlluar  
zonjë syshtqiponjë shkon Shqipëria.  
Krah saj ecën si dielli Liria  
dhe lule mban në duar...

Befas Pavdekësia u del përpara  
mbi atin e saj me shalë,  
në duar mban një libër me ar të larë,  
në libër ka shënuar emrat e atyre që ranë.

- Ç'kërkoni? — i pyet Pavdekësia
- Këtu filizat e zemrës sime ranë — thotë **Shqipëria**
- Për mua u bënë therorë — shton **Liria**.

Pavdekësia frerin e atit heq e flet qetë:  
— I njoh! Do rrojnë në kopshtin tim për jetë.

## NE STAN TEK BARINJTE

### 1.

Rrëshqiti pas kurrizë malesh dielli,  
u turbullua krejt argjëndi i dritës.  
Ra nata veshur me një tyl të zi  
dhe gozhdë të arta qiellin e gozhduan.  
Cobenjtë erdhën, u mblodhën në kasolle  
pas ziarrit që kërcente si najadë  
nën trarët e tymosur.  
Lodroinë flakët verdhacuke blu  
e flakërimën lenë në ftyra.  
Në vatrën plot thëngjij të kuq e hi  
kulacija piqet nikoqirçe.  
(Në shoqëri vec tre çobenj nuk erdhën;  
në stalla mbetën.)

Radha u takoi  
të ruanin dhëntë që do pillnin natën,  
se qëngjat dashuri e ngrohtësi kërkojnë.)  
Si zjarri, që merr zjarr ku i hedh shkarpa  
kuvendi mori zjarr n'atë kasolle,  
e lehta fjalë nis të fluturojë  
kopshijkeve, luginave, fabrikave.  
(Kasollja e vogël i nxë të gjitha veprat  
që solli sot gazeta kur arriti.)

Kuvendi kapërcen male e fusha  
dhe në kasolle sjell kopera delesh,  
këmborë, zile, fyey, kraba, struga,  
lumenj të bardhë qumështi  
dhe male leshi...

Nënqeshin buzët, sytë e çobenjve  
se gjithë pasuritë janë të tyret.

Tregojnë ata me gaz për dhën e dhi,  
për qëngja kaçurelë, që do vijnë  
të hapin blegërimën rrëth e rrëtull,  
të hidhen në lëvadhe të shkujdesur  
dhe zemrat e çobenjve të gëzojnë.  
Tregojnë ata për stanic e për jetën,  
që ka mundim e bukur të rallë,  
tregojnë për kamxhikët e veriut,  
për flokët e dëborës ledhatare,  
për shpatat, që ngul shiu përmby tokë,  
për zjarrin, që lëshon farka e diellit,  
për zjarrin e pagjumësisë, që djeg sytë,  
për yllin mëngjesor, që çel në qiell,  
për lulet e agimit,  
për perlat, që ka vesa,  
për pemët, ku kalojnë verës vapër,  
për flladin, që iu kreh aq butë flokët,  
për netët paqësore e të egra,  
për zogjtë, që i zgjojnë në mëngjes.

## 2.

Papritur, që nga flokët e dëborës,  
nga shpatat, që ngul shiu përmby tokë,  
nga yjtë, flladet, thëllëzat e bilbilat,  
nga oshëtima e fyellit e zhurma e kroit,  
nga qëngjat kaçurelë e nga bejkat,  
nga bukuritë e mendimet e tepërtë,

ai më plaku fjalën e hidhur mori  
dhe, nëpër urën që kujtesa ngre  
çdo çast e kohë,  
kaloi nga e tanishmjë në të djeshmen:  
«Tridhjetë vjet çoban — argat kam qënë  
isha një zog pa krahë e sillesha  
mes pyjeve me dhi e kecër të çelnikut.  
Më rrithë shiu, më shponte cingërima,  
kur ndjeva në damarë të më vlojë  
vitrioli i rinisë, thellë zemrës.  
Si lule çeli dashuri e parë  
për një çobankë kanakare,  
që tjetër s'kish thesar e pasuri  
përveç thesarit të rinisë  
dhe pasurisë së zemrës...  
Kur ecte, si një qiparis i pashëm,  
të rinjtë frymën pritnin e shikonin  
e pleqtë e mallkonin pleqërinë.  
Atë me zjarr të rrallë e dashurova,  
po bukuri e saj zgjoi një përbindësh,  
që flinte thellë zemrës së të birit  
t'atij çelnikut tim të egër.  
Një ditë doli dhe e ndali shtegut  
dhe fjalë gënjeshtare derdhë:  
«Të dua me një zjarr të padëgjuar!»  
I tërë trup i saj u drodh e tha:  
«Në portën e një zemre tjetër shko  
edhe trokit, se imja është mbyllur.  
I mbajnë çelësat e saj të fortat duar  
të një levendi që e dua».«  
Atij i ndezi epshin fyrrja  
e zu me njérën dorë për gëershete,  
me tjetrën u mundua t'ja mbajë gojën  
dhe desh t'i linte mu në faqe,  
si vulë turpi puthjen.

Dhe mund ta kishte shuar epshin,  
sikur tē mos mē kishte rēnē udha  
andej nga ai shteg i kobshëm.

Dhe trup i tij krenar e plot shëndet  
u bë një thes me sharka...

Kurse pér mua një greminë u hap  
rë pragun e tē zotit,  
q'ish e pamundur ta kaloja.

Kështu braktisa fshatin edhe erdha  
këtej nga fshati juaj atëhere...»

«Ç'u bë ajo që dashurove ti?» —  
i tha ahere plakut një çoban.

«Ajo tē ritë e saj nē një kasolle  
e shkoi martuar.

Atje fëmijë lindi edhe rriti  
dhe gjakun. që i mbetej pa u bërë djersë  
e bënte qumësht pér fëmijët.

Tani e krusur shkon më një fytyrë  
vendosur nē kornizën  
e flokëve tē bardha.

Atje ku tym kasoll' e vjetër nxirrte  
shkëlqejnë xhamet e shtëpisë,  
dhe brënda, si bilbilë cicërojnë  
tē sajët nipér.

Ata nuk do t'i trembë kurrë  
skifteri i varfërisë!

Kur dita ik dhe yjet që nga qielli  
me sy i bëjnë fshatit ndënë mal  
shtëpi e saj nga dritat vetëtin  
dhe hapet melodi e ëmbël.

Nga arat vjen familja e fëmijët,  
freskohet balli, trupi lodhjen flak  
veç plaku s'kthehet nē shtëpi ngaherë,  
është çoban, si ne,

edhe çobenjtë

shtëpinë e kanë mal më mal...»  
Pushoi çobani plak e tha me gaz:  
«Mos vallë doni t'ju tregoj adresën  
e plakës, që ka qënë një peri?»  
Çobenët qeshën dhe qeshja e gjerë  
gjëmoi në natën, që e mbante  
kasollen në pëqi të saj të ngrohtë.  
«E dijmë adresën. Në fshat kur shkojmë  
të fala nga ajo të sjellim.»

### 3.

Çobenjtë blegërima ndjejnë tutje  
dhe ngrihen, po në portë rritet  
shtat, i çobanit tjetër, që në duar  
dy qingja bukuroshë mban.  
Gazmor kumboi kasolles zëri i tij:  
— Vellezër, sihariq!

Ja lajmëtarët!

Erdh ora e pjelljeve!  
Si surë lumi le të zbardhin pllajave»  
— Në kroin e punës sonë  
çurkë le të jenë!  
Curkë lumtërie! —  
Me një vështrim të butë njëri sheh  
të bardhët qëngja.  
Tjetri turirin njomëzak ja përkëdhel,  
i treti zjarrin shtyn t'i ngrohë.  
U mblodhën në kasolle si familje  
të hanë të thjeshtën darkë të tyre.  
Pastaj në gji të saj të madh  
e mbylli qetësia natyrën dhe kasollen.  
Çobenjtë ranë, që të merrnin një sy gjatë  
dhe përsëri n'agim të trëndafiltë  
të ngisnin dhëntë.

37482

## TE VJELAT

U nisen bashke pasdite fshataret,  
shakate, qeshjet, kenget shponin qiellin;  
te vjelat tutje ne vreshta i thirren;  
hardhit te kishin gatitur shperblimin  
per djersen, qe si gurre rrjenjet vaditi...

Kur maleve u derdh agimi i zbehtet  
dhe gjumin zogjtë braktisen me kengë,  
u zgjuan edhe vjeliset dhe nisi vjelja.

Me shoqet erdhi vrap dhe Melpomeni,  
me krahë si te gdhendur n'alabast,  
me sy kaltroshë si një qiell maji,  
me koce hedhur pas e zbukuar  
me paparunen trendafil te fjongos,  
me zemren e saj prej pëllumbi,  
qe fshihet thelle kraharonit prush...

Një djalë e hapi këtë zemër dje  
me çelësin e dashurisë  
dhe mori një pjesë  
dhe la atje ne vend te zbrazët  
një copë nga zemra e tij e pastër.

Vjel Melpomeni shtathedhur,

vjel e mendja fluturon në krushqit;  
do vijnë ata me kuaj e saze,  
mes tyre do jetë i qeshur i dashuri i saj.

Dhe në darkë do të ndizet hareja e madhe.  
Sazet do të bien e këmbët lehtë valle do hedhin,  
me verë plot gotat do trokasini,  
kur krushqit t'i gjejë dollibashi me radhë.

Nga mushti bojëmjaltë, që derdhet tani,  
do lindë vera, që si burim i tretur do skuqë  
në gota të panumurta...

Do ngjité krahë ajo në këmbët që vallëzojnë,  
do derdhë pathos në zërat, që kënga do bashkojë...  
Kur vera e re të bëhet,

do bëhet dhe dasma...

Vjel Melpomeni mes hollë,  
vjel dhe një këngë me vehte thurr:  
«Shpejt, o rrush, shpejt, o rrush,  
bëju verë, verë dehëse, verë plot aromë».

## VARGJE PËR FSHATIN

1

Në kalimin e shekujve porsi karakoll  
qëndrojnë përkarshi krenarë e të patundur  
dy male madhështorë.

Dhe kur vështron pllajat  
në rresht njëra pas tjetrës, me honet e thella,  
me majat e larta, të kujtohet lirari,  
që më lirën e ëmbël i këndon levendëve,  
që shokut sup më sup i kanë hedhur duart  
dhe gatiten të gjithë të përdredhin valle.

Këtu, midis dy malesh, në një grusht vend,  
me ca ara baltëhollë, që shtrëngohen në këmbë  
të tyre,  
me ca korije aty-këtu, me kodrina qeroze,  
me një lumë, që kalon si gjarpër i argjëntë,  
dikur, në vite të vjetra, bujqër e barinj  
ngritën fshatrat e varfëra dhe ndërtuan shtëpitë  
si koshere në një kopësht bletësh.

2

Në një nga këto fshatra mora fryshtë e parë,  
të parën puthje e përkëdhelje nënë;

këtu shikova vajzën lulestolisur të vitit,  
që shpërthente gjoks zbërthyer nga thellësia e  
tokës

dhe veshte pemët me lule e fletë.

Këtu dëgjova ligjërim të parë bilbilash,  
dhe mbajta vesh kroin mërmëronjës.

Këtu pashë të parat lindje e perëndime ari.

Në majat e njerit mal është porta e etertë,

me prak shkrepat, me kurorë qiellin,

dhe fletë dere velat e agimit,

në ku del dielli edhe fillon shëtitjen.

E pashë që me shkopinjtë magjike të rrezëve  
të goditë pikat e vesës e t'i bëjë diamante,  
e pashë kur derdhte mbi tokë detin e dritës,  
që rreshqet në kadifenë qiellore,  
deri sa bie ngadalë në të purpurga,  
që perërdimi shtron në majat e malit përkarshi  
dhe ata errësohen e nata vjen.

Qielli var medaljet e tij të florinjta,

Zogjt shkojnë të prehen në foletë. Natyra kthehet  
dhe fle në gjirin e çetësisë.

I padremitur rrëshqet vetëm lumi  
e shushuritja e tij ngjan melodinë e një ninulle.

Herë-herë era sikur të zgjohet nga gjumi,  
frym me furi në gjethë e fle sérish.

Atje së pari dëgjova të vrapijnë  
kuajt e veriut dhe pashë qiellin lart  
të mbulohet me retë bojë hiri.

Dhe ashtu, si qiellin të murmë e të vrejtur,  
vështrova shumë sy të shuar e të vrarë.

Edhe në lozta një çast një gëzim ndër ata sy  
shuhej shpejt, ashtu si feks në gjerësinë e eterit  
dhe fiket drita e vetëtimës.

Dhe ashtu siç bëhet nata cep më cep me sterrë  
ndiqte hidhërimi ndriçimin e syve.

Por, siç shpérndan veriu retë nga qielli  
dhe duket sikur lanë kadifen kaltëroshe,  
u shpérndanë një ditë retë e brengave  
dhe, si ndrit natyra nga dielli, pas shiut,  
pashë të shkëlqejnë zemrat në shkëlqimin e syve  
dhe duart të shtrëngojnë pushkën gojëflakë  
dhe gjaknë të derdhet në baltën e etur,  
dhe fitoren të shpérndajë dehjen e saj,  
dhe Lirinë të përhapë fshatrat e gjera,  
dhe llërët e nxira nga dielli të përvishen,  
dhe fshatin të rilindë nga hiri i tij.  
Pashë fshatarët të ecin në një rrugë të re.  
Dhe sa më shumë ecin në këtë rrugë,  
më i sigurt bëhet çapi i tyre burrëror,

Kodrat, rrëth fshatit, po vishen me pemë.  
Piqen në mijra degë frutet:  
mollë si faqe vajzash, qershi si buzë vajzash,  
dardhë plot shije dhe fiq me mjalt' gatuar.  
Rrushi ndër vreshta shkëlqen qelibar.  
Në pllajat kumbojnë zile e këmborë;  
në ajër derdhen tingujt e fyellit...

Dhe pas lodhjes dhe zjarrit të punës,  
shpesh, në vatër ndizet hareja:  
sazet gostisin magjinë e harmonisë;  
zërat ecin të bashkuara me vargun levend,  
duart lidhen si një zinxhir shoqërisht,  
këmbët lozin me shkathtësi vallen.

Të bukur shoh të tashmen dhe të ardhmen më të bukur.

Përmes shpellash, që rrënje kanë hedhur në tokë, që s'i tundin tërmetet, rrugën e gjatë do marrin maqinat që të vijnë këtej me këmbë të rrumbullakta.

Dhe në shtëpitë, që kandila të zbehta ndriçonin, netëve do shkëlqejnë si yje llambat elektrike dhe dritaret do duken sikur kanë veshur perde floriri.

Në shtëpi, kur dikur oshëtinin ohet dhe vajet, nga kuajt e eterit do zbresin në radio këngë të flakta jete...

## SHQIPONJAT

Sikur të kishin zë njeriu e mendje njeriu të kishin shqiponjat, që gërxheve kanë foletë, të cilat këmba e askujt s'i shkeli dot, se krahët e tyre shtrihen e notojnë në eter, duke kërkuar drekë e darkë me sy gjumashe, kur njerëzit e lirë të shihnin, të nënështronin mbretërinë e tyre e shtigje jetës t'i hapnin mbi shkrepë,

fjalën do merrte njëra prej tyre:  
— Shoqë shqiponja,

ka qenë një kohë kur njerëzit  
Vështrimin tonë admirronin, që çaste largësitë  
dhe krahët tonë, që afër diellit na ngjitnin  
me ne krahasonin shokët e tyre më trima.  
Po erdhën vite të tjera:

u vjetërua ky krahësim.  
Ç'janë krahët tonë para flatrave të njerëzve

flatrave që ju dha atyre Partia  
për fluturime të larta, të larta.  
Shoqe Shqiponja?... tē lirē,

## KËNGËVE POPULLORE

O këngë valë-valë, o këngë ritme, ritme,  
ju mbushi trimëria me zjarrin e lirisë  
ju nxorri lart nga zemra tërmët i dashurisë,

O këngë psherëtime të gajdeve të lashta  
dhe murmurime kroi dhe ëndra shpeshërie  
dhe tingëllime brengash nga gjokse violie

magji e mendies jini dhe dehje e zemrës jini:  
nga telat e lahutës ju derdhени plot hie  
kur bashi i poetëve:

populli, ju bie...

## KUR KTHEHET VAPORI

Kur kthehet vatori, që sjell kurbetlinj të munduar,  
të vojtur, të rrahur, si zogj, nga stuhi e tērbuar,  
pse dallgën e hap me gjoksin e tij në rrëmuje,  
sikur tē hapte një varr tē trishtuar në ujë?  
A thua kërkon tē varrosë në fundin e detit  
mundimet farmak tē kurbetit?

## I RILINDURI

Si fes i bardhë atij i rrijnë flokët,  
parmenda e kohës hapi brazda shumë;  
përgjigjet (kur përmoshë e pyesin shokët):  
«Dy herë linda ja këtu mbi lumë,

një herë kur më polli nëna e vuar,  
një herë tjetër kur lindi Partia.  
Dy nëna trime më kanë mëkuar  
me shpresë plot e ëndëra me mijë.

Si mal me borë koka ime duket,  
po zemrën unë e kam njëzetvjeçare!  
Dikur në jetën time vojtja futej,

si krimb përbuzja hynte në damarë...  
Njeri jam sot! S'përulem, s'vuaj s'lutem,  
se fatin tim në duar e kam marrë».

## ËNDRA E SHUAR

*Atit tim!*

Si qiri ish fytyra jote e zbehtë,  
në zjarrin e sémundjes digjeshe;  
mërgimin e zi, o at' i shkretë,  
mallkoje e përcart flisje:

«Ah, m'u rëndua si gur ky mërgim!  
Më kyçi me kyçe të panumurta çdo ëndër,  
më kyçi çdo shpresë, çdo gjëzim  
thellë të raskapiturës zemër.

Më mori malli të shoh atë dritë,  
që pashë për herë të parë dikur..  
Më mori malli, o Atdhe im i dlirtë...  
Të lag me lot një grusht toke, një gur,

në gjoks të marr djalin tim të vetëm,  
në dasmën e tij të ngre dollë me verë:  
të tunël në pëçqì nipin e mbesën,  
të bredh me ta mes barit të papreri».

Kështu psherëtije, o at' i ngratë,  
po vdekja të dëgjojë në dhomën e zbrazur  
dhe me kosë në dorë atë natë  
shpërtheu një qeshje të ftohtë si akull.

Ti qeshjen e saj e kuptove atëherë,  
se kështu ajo qeshte me jetë të panumurta;  
mërgimi varre hap në dhera të tjerë  
dhe ve kryqe me ftohtësi të gurtë...

## BISEDEË ME VETEVEHTEN

Shoh në një rreze dielli dritën, në një lule pranverën,  
me një të puthur mijra fjalë më flet dashuria,  
në një këngë të shtruar shoh gostinë me gaz e verë,  
në një violinë gjej gurrën nga derdhet harmonia,  
më rrëfejnë kopshtin faqet flakë të trëndafilit,  
dega e ullirit më kujton heroin pranë lavdisë,  
pema me fletë më flet për flladet dhe bilbilët,  
agimi më thotë për vitet e ardhëshëm të lumturisë.  
Ndonjeri zërin e tyre s'e ndjen, e ka vështirë,  
po unë me to merrem vesh mirë.

## N È N A

Ja mbyllte qerpikët në vitet rinorë  
Morfeu<sup>1)</sup> më gishta të butë, të butë  
dhe e shpinte në vende t'ëndrave prrallore,  
e shëtiste skutë më skutë.

Agimi ja përkëdhelte kraharorë  
dhe prap qerpikët e mbyllur ja puthte.

Kaluan vitet radhë. U bë grua.  
U mbyll në fole të saj bashkëshortore.  
Me përkëdhelitë e burrit u mësua  
dhe u deh nga puthjet e tij prore,  
po ajo prap ish dhe e Morfeut dashnore.

Nga zemra e saj mbiu si lule në arë  
një çupkë-bukuroshkë topolake,  
që e solli dashuria, mall i parë,  
dhe e pëershëndeti dielli kryeàflakë.  
Pa nëna, që humbiste n'ëndrra pa andrralla,  
vjedhurazi mbyll tani qepallat

edhe kur fle, mbi djep ajo le rojë,  
le rojë dashurinë e saj amtare,  
që kur ta ndjejë zërin vocërrak, ta zgjojë  
dhe në gji ta marrë.  
Pothuaj gjithnjë, mbi djep, të krusur  
e gjen tani agimi i purpur.

---

1) Morfeu — perëndia e gjumit.

## P R A N V E R A

— *Pejsazh* —

İ nguli kömbët e tij në natyrë dimri i paturpshëm;  
tierë frerin e erës ngre e vrapin e marrë nget,  
herë duket se kreh në eter me krehër të padukshëm  
shtëllungat e reve dhe zbokun e borës heq.

Po ndonëse rrabin erërat natyrën e mpirë  
dhe hera herës mbretëron e varrit qetësi,  
**pranvera shpejt do vijë plot bukuri e hir,**  
toka e mëkon dhe e përkund si nëna në pëqi.

## NJË KËNGË E GJALLË

I ulur rri poeti në tryezë  
e ndjen si rrabin fletëzat e zemrës.

Një këngë plot stoli e jetë  
kërkon të mbjellë vijave të letrës,

një këngë të qëndisur me brilantë,  
që deti i ndjenjave të tij shpërndan...  
Në fantazinë e vet fëmijët jashtë  
vrapojnë e hidhen ëndrat shatërvan.

Dhe bukurisë së shpirtit fëmijror,  
dhe buzëqeshjeve në gjethë e fletë,  
që çelin si agimi pranveror,  
me varg poeti do t'ju japi jetë.

Po, ah, më kot mundohet shumë i shkreti  
të pikturomë hiret e fëmijëve!  
Të varfra mbijnë strofat dhe poeti  
gërvisht me penë prap mes vijave...

Kur befas e gëzuar hyn në dhomë  
vajza e poetit, e vogla flokëartë  
dhe hyn me të nektari plot aromë  
dhe dridhet heshtja nën tavanë e lartë.

Një zë i nurshëm ndjehet si një notë,  
që del nga ndonjë hark i lehtë,  
kur puth dal e nga dal telin e ftohtë  
dhe violinës plakë i jep jetë.

— Këndo një këngë — i tha baba-poeti.  
Ajo padashur ngriti sytë ëmbël  
dhe faqen mu në doçkë e mbështeti  
e tha:

— Babaçko, unë jam këngë!

Poeti qeshi dhe në tavolinë  
e la të shkretën penë menjëherë,  
e përqafoi me dashuri të bijën,  
ndërsa në dhomë maji sillte erë...

## MIGJENIT

— Duke përkthyer poetin —

Zë grek u dhashë vargjeve të tua,  
dhe vura nga zemra ime një pjesë,  
që qelli i mendimit tënd të jetë i kulluar  
dhe gjërësia oqeanike e shpirtit mos vdesë.

S'kam mbyllur sy në dhomë shumë netë,  
që të flasin një zë të huaj, po shqiptarë  
të mbeten, si lindën, të rreptë,  
mbushur me brengë e me zjarr...

Sa më shumë hyja në varg — më dëgjon? —  
i ngjaja një minatori ari,  
që gjen më tepër ar, sa më tepër kërkon.

S'do desha shpérblim më të madh asnjëherë,  
mjafton që më ngrohe me zjarrin  
dhe unë ndihmova të ngrohen të tjerë.

## PËR DASHURINË

1.

Vallë kur do vish, s'e di,  
Di vetëm  
se ti do vish... Dhe mirë ardhësh, vashë!  
Në zemrën time unë një fron kam ngritur  
— Ulu! — do të them imë buzë të zhuritur...  
Të ëndërroj ty netëve pa gjumë  
të dlirtë, të bukur dhe të thjeshtë,  
me zemër, që përhap si filad në lumë  
aromën e mirësisë së përjetëshme...

2.

Ma kënda zemrën mbushur dhëmshuri,  
që thellësi e saj burim të jetë  
për dashurinë e freskët pa kufi,  
për dashurinë, që mos ndryshket e mos vdesë.  
Po dua që në zemrën tënde, vashë,  
të jenë tok besimi dhe urrejtja,  
që të ecni rrugëve të jetës bashkë  
atje ku zjecnë mundi dhe përpjekja!

3.

Eh, ç'dua unë!

Unë dua që ti krahë  
të kesh

e vallen e jetës mos e ndalësh  
dhe zemra lartësirash të të rrashë  
dhe drithma të mos njohë,  
vashë!

4.

E dij se ti e tillë do të vish,  
dhe mirë se të vish në fronë e zemrës,  
dhe mirë se të rrish  
për jetë në agimin e pranverës...

## P J E R G U L L A

1.

Unë kaloja  
rrugicës së ngushtë  
dhe ti me gishtrinjtë e tu të butë — të butë  
nën pjergullën e portës sate tirje, o vashë,  
dhe vërtitje — vërtitje boshtin e trashë.  
Nga trendafili i gazit, që të çeli në buzë  
e ndjeva dashurinë e në mendime rashë,  
e ndjeva dashurinë, që lidhi fillin e saj të paduk-  
shëm  
nën pjergullën e portës sate tirje, o vashë...

2.

Vitet  
degët e pjergullës i thanë pastaj...  
E harruan pjergullën dhe ata  
që gjetën harresë në verën e saj  
dhe ata, që gjëzimin gjetën.  
Vetëm në kujtimet e mijë ajo e njomë do mbetet,  
se dashuria e parë çeli nën fletët e saj,  
kur era u thoshte luleve të putheshin në maj  
nën pjergullën e portës sate tirje, o vashë,  
dhe vërtitje-vërtitje boshtin e trashë...

## PUTHJA E PARË

### 1.

Nata e prillit me duar të buta  
lëshonte tylin e saj, e yjtë  
u shëmbëllenin qëndismave me tel ari  
që dora e padukëshme e një mjeshtri qëndisi...  
Dhe toka frymë merrete, dhe fryma e saj ishte  
kundërmimi i luleve.  
Eistrica rrukulliste kristalet e saj të shkrira  
dhe diku, larg e derdhte.  
Shtëpitë, që tërë ditën i nanuriti qetësia,  
i zgjoi prapjeta:  
ktheheteshin ata nga fusha.

### 2.

Eh, kish kohë që Leni ndjente në gjoksin e saj  
një dridhje të ëmbël,  
kur para saj Nikon e shihte...  
Memecë bëhej e në faqe i mbinin lulekuqe.  
Shigjetë ishte shikimi i tij  
në fletëzat e zemrës së saj...

3.

Eh, natën e prillit Nikua hapat ç'i bëri të vogla.  
Leni vinte nga fusha, Leni shpejtonte.  
Dashuri, dashuri!  
Aortat shtynin gjakun në zemër,  
zemrat goditnin gjokset me grushte.  
Fryma e ngrohtë faget e njëri tjetrit ngröhu!

4.

Trokitën, trokitën zemrat...

Nikua gishtirnjtë e ashpër  
i shkoi në krahun e vashës  
dhe ahere ata si pesë pole manjetike  
baterinë e emocionit derdhën në trupin e saj.  
Vetëm sa pëshpëriti: «Do të na shohin»!

5.

Në qetësinë e natës së prillit,  
nën xhufkën e shtatit e të ullirit  
duart e Nikos u bënë unazë  
rreth mesit të hollë të vashës  
dhe buzët e flakta me flakë dashurinë vulosën.  
Ish e bukur puthja e parë,  
ish e ëmbël puthja e parë  
më e ëmbël se nektari.  
Nektari s'matet me të si do që të jetë...  
Ktheheshin Leni e Nikua nga fusha...  
Kur nata e prillit me duar të buta  
lëshonte tylin e saj...

## TRA DHËTARI

Pashë një trathëtar, që plumbi kish rrëzuar  
për tokë,  
pashë Atdheun, që i rrinte me shpatë mbi kokë.

Kufitë tanë me lumej gjaku vaditur  
desh t'i kalonte ky njeri i mërzitur.

Ai ish fantazmë dhe errësirën kish nënë,  
urrente buzëqeshjet, urrente diell e hënë.

Po para se zëmbakët të mbillte agimi i artë,  
sytë ja mbylli e përjetëshmjë natë.

Ahere dëgjova vdekjen të qeshë si e marrë:  
Ai ish imi. Me kohë unë e kisha marrë!»

## TRYEZA E LËNDËS

	Faqe
Partia flet .....	3
Republikës .....	5
Strofa për ditën kur erdhën partizanët .....	6
Çlirimë .....	10
Yjet .....	11
Të pavdekshmit .....	12
Në shtan tek barinjtë .....	13
Të vjelat .....	18
Vargje për fshatin .....	20
Shqiponjat .....	24
Këngëve popullore .....	25
Kur kthehet vaponi .....	26
I rilinduri .....	27
Endra e shuar .....	28
Bisedë me vetveten .....	30
Nëna .....	31
Pranvera .....	32
Një këngë e gjallë .....	33
Migjenit .....	35
Për dashurinë .....	36
Pjergulla .....	38
Puthja e parë .....	39
Tradhëtari .....	41